



VENDIM I PLOTFUQISHËM
GJYKATA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC

20. 01. 2017

P.nr.1148/16

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, me procesmbajtësen Nora Rushiti – praktikante e kësaj Gjykate, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED] i akuzuar sipas Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1156-6/16 të dt. 30.11.2016, për veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1156-6/16 të dt. 30.11.2016 për dhënien e urdhrin ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt.12.12.2016 mori këtë:

AKT GJYKIM

PRANOHET, kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1156-6/16 të dt. 30.11.2016, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri: [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna Ferizaj, i lindur me [REDACTED], në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED], i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,.

ËSHTË FAJTORË

Sepse me date. 18.06.2016 rreth orës 11:00 në pyllin shoqërorë të cilin e menaxhon Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari në rajonin ekonomik pyjor Nerodime – Jezerc në vendin e quajtur "Mullijt e Gjynaheve", me qëllim vjedhje me sharrë motorike ka prerë 15 copë dru të llojit ah, me dimensione të gjata-boniteti III m, me diametër 20-22 cm, gjithsejtë në kubaturë prej 2.85 m, të cilin e ka bartur me qerre kuajsh, vlera e dëmit të shkaktuar është 436.05€

-me të cilën ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,21,41,46,73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së

G J Y K O N

I pandehuri , me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është e obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1 (një) ditë burg.

Obligohet i akuzuari që t'a kompenzoj dënimin e shkaktuar të demtuarës – [REDACTED]

I [REDACTED] në lartësi prej 436.05 €,

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.1156-6/16, të dt. 30.11.2016 ka akuzuar të pandehurin [REDACTED] për veprë penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP/II.nr.1156/16, të dt. 30.11.2016, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj veprë penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1. të KPPK-së.

Gjykata pasi shqyrtoj provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: procesverbalit me nr.301/2016 i dt.11.07.2016, fletëparaqitjes së rojës së pyllit të Drejtorisë për

Bujqësi dhe Pylltari-Sektori i Pylltarisë në Ferizaj me nr. 301/2016 i dt. 11.07.2016 për vlersimin e dëmit, vërtetoj se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se e pandehura e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtore dhe i shqipton dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari që t'a kompenzoj dëmin e shkaktuar të demtuarës - [REDAKTUAR] Ferizaj në lartësi prej 436.05 €,

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 (njetete) € në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga arsyet e sipër cekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.1148/16 datë 12.12 .2016

**Procesmbajtëse,
Nora Rushiti - Praktikante**

**Gjyqtarja Individuale,
Hakile Ilazi**



KËSHILLË JURIDIKE:

Kudër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.